

Strategjia e Advokacisë së Grupit të Aktivistëve në Bashkinë Dibër 2016 - 2019



Mirënjohje

Partnerë për Fëmijët ka dëshirë të shprehë mirënjohje për kontributin dhe punën e anëtarëve të Grupit të Aktivistëve në Bashkinë Dibër, pa të cilët, nuk do të ishte bërë e mundur zhvillimi i kësaj strategjie advokuese. Në vazhdim, autori ka dëshirë të falenderojë Nevila Manga dhe Gonxhe Kandri për mbështetjen dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përmbajtjes së kësaj strategjie.



Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Hyrje | 4 |
| Procesi i Zhvillimit të Strategjisë | 6 |
| Niveli Aktual i Shërbimeve në Bashkinë Dibër | 7 |
| Shërbimet Prioritare të Identifikuara nga Studimi | 10 |
| Përcaktimi Advokacisë | 12 |
| Qëllimi i Grupit të Aktivistëve në Bashkinë Dibër | 14 |
| Metodat Advokuese | 17 |
| Plani Strategjik 2016 – 2019 | 30 |

Hyrje

Advokacia në të vërtetë është arti i ndryshimit të politikave dhe praktikave nga njerëzit që janë në.¹

Kjo Strategji Advokuese është produkti i punës së Grupit të Aktivistëve në Bashkinë Dibër pas gjashtë muaj nga krijimi i tyre. Anëtarët e Grupit janë të moshës 16 deri në 45 vjeç, meshkuj dhe femra të cilët vijnë nga Dobrova, Maqellara, Muhurri, Peshkopia, Pilafe dhe Tomini. Anëtarët e grupit janë nëna, baballarë, nxënës, mësues, gra biznesmene, drejtore kopështi, rrobaqepëse, përfaqësues nga shoqëria civile dhe psikologë.

Grupi Aktivistëve është krijuar në Prill të vitit 2016 në kuadër të projektit "Advokaci Komunitare për Shërbime Sociale në Bashkinë Dibër", projekt i cili është mbështetur nga LëvizAlbania dhe zbatuar nga Partnerë për Fëmijët. Disa nga anëtarët e Grupit të Aktivistëve kanë marrë pjesë në projektet e mëparshme që ka zbatuar Partnerë për Fëmijët në Dibër në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe të cilët kanë treguar interes për t'ju bashkuar këtij grupi ndërsa anëtarët e tjerë janë ftuar nëpërmjet kontakteve në komunitet. Të gjithë anëtarët marrin pjesë vullnetarisht në takimet e grupit dhe aktivitetet e tij.

Parimi i këtij projekti është:

"Advokacia është procesi i pjesëmarrjes së njerëzve në proceset vendimarrëse që ndikojnë jetët e tyre."²

¹ <http://umbrellanetwork.org/wp-content/uploads/2011/04/Endevour-Advocate-Booklet.pdf>

² Ibid¹

Qëllimi i projektit është:

Fuqizimi i anëtarëve të komunitetit të Bashkisë Dibër në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve sociale për të rinjtë dhe të rriturit në nevojë.

Objektivat e Projektit janë:

1. Të zhvillojë kapacitetet e grupit komunitar për të advokuar pranë strukturave të pushtetit lokal në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve sociale në Bashkinë Diber.
2. Të përmirësojë ndarjen dhe shkëmbimin e informacionit midis qytetarëve dhe pushtetit lokal në Bashkinë Dibër duke fuqizuar pjesëmarrjen qytetare dhe vendimmarrjen.

Procesi i Zhvillimit të Strategjisë

Anëtarët e Grupit të Aktivistëve kanë zhvilluar një pyetësor prej 4 faqesh. Pyetësori ka përfshirë pyetje të cilat fokusohen në llojet e shërbimeve sociale, arsimore dhe të mbështetjes që ofrohen aktualisht në Bashkinë Dibër dhe gjithashtu për llojet e shërbimeve apo ndihmës që anëtarët e komunitetit do të donin që të ofroheshin nga pushteti lokal ku ata jetojnë.

Pyetësorët janë administruar nga vullnetarët dhe anëtarët e Grupit të Aktivistëve në njësitë vendore në Peshkopi, Kastriot, Maqellarë, Brezhdan, Rrashnapojë dhe Muhurr gjatë periudhës Gusht – Tetor 2016. Në total janë plotësuar 750 pyetësorë.

Tetë anëtarë të Grupit të Aktivistëve kanë bërë hedhjen e të dhënave në një database në për të analizuar të dhënat e mbledhura.

Kjo strategji është hartuar në bazë të analizës së të dhënave të studimit dhe strategjive se si të advokojnë më mirë për prioritetet e identifikuar nga studimi.

Niveli Aktual i Shërbimeve në Bashkinë Dibër

Të intervistuarit janë pyetur se çfarë shërbimesh ofrohen aktualisht në fshatrat, qytetet apo komunitetet e tyre.

Më poshtë është lista e shërbimeve të përmendura.

Shërbimet që aktualisht ofrohen

Tabela 1

| Shërbimet | Numri i personave që janë përgjigjur |
|--|--------------------------------------|
| Ndihma Ekonomike | 364 |
| Pagesa e papunësisë | 44 |
| Pagesa e aftësisë së kufizuar (KEMP) | 76 |
| Pagesa e kujdestarit për një fëmijë apo të rritur me aftësi të kufizuara | 24 |
| Pension pleqërie | 237 |

Përvec shërbimeve të mësipërme, të intervistuarave i'u është ofruar një listë me shërbime sociale të mundshme për të cilat janë pyetur nëse do të donin që këto shërbime të ofrohen në komunitetin e tyre.

Ju lutem referojuni Tabelës 2.

Shërbimet Sociale që ofrohen ose jo

Tabela 2

| Llojet e Shërbimeve Sociale | Numri i të intervistuarve të cilët kanë deklaruar shërbimet sociale specifike që janë në dispozicion ose jo | |
|---|--|-----------|
| | PO | JO |
| Kopësht apo çerdhe për fëmijët që nga lindja deri në 7 vjeç | 650 | 85 |
| Grup për nënat e reja | 46 | 638 |
| Klasa prindërore | 54 | 627 |
| Qendër ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara | 0 | 699 |
| Qendër ditore për të rriturit me aftësi të kufizuara | 0 | 666 |
| Qendër ditore për moshën e tretë | 116 | 589 |
| Qendra apo shërbime rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara | 3 | 686 |
| Vizita në shtëpi nga stafi i shëndetit parësor | 564 | 138 |
| Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve | 109 | 561 |
| Zyra e Familjes/Genderit | 82 | 603 |
| Shërbime për shëndetin mendor | 32 | 659 |
| Bibliotekë për fëmijët | 330 | 370 |
| Kënde lojrash (publike ose private) | 58 | 645 |

Nga përgjigjet e dhëna është e qartë që disa njerëz kanë akses në shërbimet sociale dhe disa të tjerë nuk kanë. Aktualisht në Bashkinë e Dibrës nuk ofrohet shërbimi i një qendre ditore për fëmijët apo të rriturit

me aftësi të kufizuara, dhe vetëm rreth një e katërta e të anketuarve janë në dijeni se ka një qendër ditore për personat e moshuar.

Mbrojtja e fëmijëve dhe ofrimi i shërbimeve për të përmbushur nevojat e fëmijëve në rrezik të lëndimit, keqtrajtimit, neglizhencës apo trafikimit ka qenë prioritet i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë që nga viti 2010, por më pak se një e pesta e të anketuarve ishte në dijeni të ekzistencës së një njësie për mbrojtjen e fëmijëve dhe shërbimeve që ajo ofron.

Gjithashtu, mungesa e këndeve të lojrave për fëmijët ishte një nga nevojat e identifikuara gjatë studimit.

Shërbimet Prioritare të Identifikuara nga Studimi

75% e të anketuarve kanë deklaruar se shërbimet që mungojnë aktualisht dhe që ata do të donin që të ofroheshin në komunitetin ku jetojnë janë:

1. Fëmijët me aftësi të kufizuara:

- ❖ Një qendër ditore e pajisur me specialist: fizioterapist, logopedist, etj – 63%
- ❖ Paisje si paterica dhe karrige me rrota - 8 %
- ❖ Pagesa më të mira të aftësisë së kufizuar - 6 %
- ❖ Psikologë - 3 %

2. 60 % e të intervistuarve janë shprehur se për të rriturit me aftësi të kufizuara do të donin:

- ❖ Qendra ditore - 80 %
- ❖ Pagesë për kujdestarët - 18 %
- ❖ Rritje të shumës së ndihmës ekonomike - 2 %

Në vazhdim, 40% e të intervistuarve janë përgjigjur se do të donin të kishin shërbimet sociale të mëposhtme:

- ❖ Zyrë për Mbrojtjen e Fëmijëve - 32 %
- ❖ Shërbime Psikologjike - 36 %
- ❖ Punonjës Social - 21 %
- ❖ Shërbim Këshillimi - 11%

Të intervistuarit gjithashtu përmendën se ata do të donin të kishin më shumë kopështe dhe shkolla dhe/ose përmirësime të gjëndjes së ndërtesave aktuale duke përmirësuar në këtë mënyrë aksesin dhe mjedisin mësimor.

Nëpërmjet analizimit të të dhënave, katër prioritetet e dala për përmirësime janë:

1. Hapja e një qendre multidisiplinare me specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara - 367 të intervistuar;
2. Përmirësimi i shërbimeve sociale duke përfshirë, vendosjen e mësuesve ndihmës, gjëndjen e shkollave dhe kopshteve dhe hapja e kopshteve të reja - 164 të intervistua;
3. Rritja e pagesës mujore të Ndihmës Ekonomike - 117 të intervistuar;
4. Ndërtimi i këndeve të lojrave për fëmijë - 111 të intervistuar.

Përcaktimi i Advokacisë

Në këtë strategji përcaktimi i advokacisë është:

Advokacia është një aktivitet i kryer nga një individ apo grup individësh që kanë si qëllim që të ndikojnë në sistemet dhe institucionet politike, ekonomike dhe sociale. Advokacia mund të përfshijë disa aktivitete që një person apo organizatë/grup ndërmerr, përfshirë këtu fushata mediatike, fjalime në publik dhe publikimi i studimeve apo kryerja e sondazheve³.

Grupi i Aktivistëve në Bashkinë Dibër është një grup i përbërë nga individë të interesuar dhe nga një grup qytetarësh dhe për këtë arsye përcaktimet në vazhdim rreth llojeve të advokacisë mund të aplikohen për këtë grup.

Grupi advokues përbëhet nga njerëz që ndajnë të njëjtat eksperiencë, pozita apo vlera dhe mbledhen sëbashku për të diskutuar dhe dëgjuar njëri-tjetrin dhe për të folur në emër të kolektivit rreth çështjeve që janë të rëndësishme për ata. Këto grupe kanë si qëllim që të influencojnë opinionin publik, politikën dhe ofrimin e shërbimeve.

Madhësia, influenca dhe motivimi i tyre është i shumëllojshëm. Përfaqësuesit e grupeve lokale zakonisht janë të përfshirë në komitete planifikuese dhe në komisionet dhe monitorimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale.

Advokacia qytetare ka si qëllim që të përfshijë njerëz nga komunitetet lokale duke i dhënë mundësi atyre që të kenë një zë dhe të marrin vendime për gjërat që ndikojnë jetët e tyre. Partneritetet e advokacisë qytetare janë me kohë të gjatë, nuk janë të kufizuara në kohë dhe zgjasin për aq sa qytetarët advokues dhe individët duan.

³ <https://en.wikipedia.org/wiki/Advocacy>

Qytetarët advokues janë anëtarë të zakonshëm të komuniteteve lokale. Ata nuk paguhen dhe zakonisht funksionojnë me mbështetjen e një skeme të koordinuar.⁴

Në kuadër të kësaj strategjie Grupi i Aktivistëve do të përdorë **Advokacinë e Sistemeve**, e cila përfshin “ndryshime në politika, programme, praktika dhe sjelleje të institucioneve publike dhe private, duke përfshirë ligjet e qeverisë, shërbimet dhe politikat”. Për shembull, iniciativat mund të jenë të tilla si apelimi tek institucionet ose bizneset për të ndryshuar strukturën e tyre administrative, praktikat apo ofrimin e shërbimeve. Mund të përfshijë gjithashtu edhe ndërmarrjen e iniciativave për të ushtruar presion tek qeveria me qëllim ndryshimin e ligjit apo për të prezantuar politika apo programe të reformuara.

Në përgjithësi qëllimi i advokacisë së sistemeve është që të promovojë ndryshimet për të përmirësuar apo mbështetur të drejtat ligjore dhe sociale të grupeve të veçanta dhe të adresojë pabarazitë në shoqëri.

Puna në këtë advokaci fokusohet përgjithësisht në influencimin e vendim – marrësve për të ndryshuar politika, programe apo sisteme për përftimin e grupeve të njerëzve .⁵

Qëllimi i Strategjisë së Advokacisë

“Janë aftësitë dhe teknikat që ju përdorni në mënyrë efektive për të bindur qeverinë apo të tjerët që kanë fuqi të ndryshojnë mënyrat e tyre të të menduarit dhe bërjes së gjërave.”⁶

⁴ <http://www.scie.org.uk/care-act-2014/advocacy-services/commissioning-independent-advocacy/inclusion-empowerment-human-rights/types.asp>

⁵ <http://www.fcssaa.org/sites/default/files/documents/Module%205%20Advocacy.pdf>

⁶ <http://umbrellanetwork.org/wp-content/uploads/2011/04/Endevour-Advocate-Booklet.pdf>

Qëllimi i Grupit të Aktivistëve në Bashkinë Dibër për periudhën 2016 - 2019 është të:

1. Planifikojë, zhvillojë dhe të ketë të paktën një qendër shumë-funksionale ditore për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara në Bashkinë Dibër deri në vitin 2018;
2. Deri në Shtator 2017, të përmirësojë aksesin në ofrimin e shërbimit arsimor dhe ambjenteve për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e Bashkisë Dibër. Këtu përfshihet ofrimi i mësuesit ndihmës; akses në kopshte dhe shkolla për të gjithë fëmijët dhe të rriturit dhe transport falas nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara në lëvizje;
3. Përmirësimi i aksesit dhe nivelit të pagesës mujore të Ndhmës Ekonomike për individët dhe familjet në Bashkinë Dibër deri në 2018:
4. Rritja e numrit të këndeve të lojrave të aksesueshme dhe të sigurta për të gjithë fëmijët e vegjël në komunitet lokale, për çdo vit deri në 2019.

Qasja e Advokacisë që do të përdoret për të Arritur Qëllimet

Ka disja qasje për të bërë advokaci, por e rëndësishme është që të kesh një plan strategjik, një sistem veprimi dhe rishikimi në mënyrë që anëtarët e Grupit të Aktivistëve në Bashkinë Dibër mund të shohin lehtësisht se çfarë është arritur, çfarë qasjesh duhen përdorur për të patur rezultate më të mira dhe kush janë hapat e ardhshëm për të arritur rezultatet përfundimtare.

Plani advokacisë duhet të ndiqet me parime dhe qëllime SMART. Për të patur një shëmbull, ju lutem referojuni Tabelës 3.

Tabela 3

| | |
|---------------------|--|
| Specifike | Tregon se çfarë (psh çfarë sjellje, nga kush ose kush është produkti) dhe sa duhet të arrihet (psh 40%) dhe kur (psh deri ne 2018). Është e rëndësishme që të jeni sa më të detajuar për atë që doni të arrini dhe kur doni t'a arrini atë. |
| E matshme | Ju duhet të jeni në gjëndje të mblidhni informacion rreth objektivit tuaj në mënyrë që të masni progresin. Përpiquni që të jeni sa më i saktë që të mundeni. Me fjalë të tjera, qëllimet tuaja duhet të identifikojnë atë që ju doni të ndryshoni/arrini dhe t'i përgjigjeni pyetjes: për sa kohë? |
| Të arritshme | Qëllime realiste dhe të arritshme brenda mundësive që ka grupi/organizata juaj. Qëllimet tuaja duhet të identifikojnë kush do të bëjë ndryshimin. Vendosni qëllime që organizata/grupi juaj mund të arrijë. |

| | |
|-----------------------|---|
| Përputhshmëria | Qëllimet duhet të jenë të përputhshme me misionin e organizatës/grupit. Organizata apo grupi juaj duhet të ketë një kuptueshmëri se si qëllimet e planit advokues përputhen me misionin e përgjithshëm të organizatës/grupit. |
| Afatet | Ju duhet të vendosni afate për arritjen e qëllimeve tuaja në planin e advokacisë, duhet të vendosni data për përmbushjen e çdo qëllimi. Edhe nëse duhet të rishikoni afatet, është e rëndësishme të vendosni data për arritjen e qëllimeve dhe të përpiqeni që të përmbushni këto afate/data pasi do t'ju ndihmojnë që të qëndroni të fokusuar në arritjen e qëllimeve. |
| Sfidues | Qëllimet duhet të ndihmojnë grupin që të vendosë përmirësime domethënëse që janë të rëndësishme për anëtarët e komunitetit. Synoni për qëllime sfiduese por realiste. |

Metodat që Mund të Përdoren për të Advokuar

Më poshtë jepen disa metoda/modele advokimi që mund të përdoren për kauza apo për të ndryshuar politika, ligje apo çështje në nivel lokal.

Petitionet:

Si funksionojnë petitionet?

Në fund të fundit, sa më shumë njerëz që nënshkruajnë një petition, më shumë gjasa ka që qeveria, lokale apo qendrore ose një kompani, të përgjigjet ose të bëhet përgjegjëse.

Verifikoni që kauza për petitionin tuaj është nën juridiksionin e qeverisë tuaj lokale. Kontaktoni zyrën administrative të qeverisë tuaj lokale ose kontrolloni në faqen e tyre të ëbsit-it. Ndoshta ju duhet të bëni një petition në nivel qarku apo në nivel kombëtar. Kërkoni që të shkoni në zyrën e cila merret me çështje që kanë të bëjnë me kauzën tuaj. Më pas bëni kërkime se si mund të bëni një petition.

1. **Gjeni se sa firma ju duhen.** Kjo është shumë e rëndësishme. Do të ishte e tmerrshme nëse ju vendosni një qëllim për të mbledhur 1 000 firma, t'a arrini këtë qëllim, dhe me vonë të kuptoni se keni nevojë për 2000 firma. Gjithashtu, shikoni nëse peticioni juaj ka nevojë për aprovim para se t'a qarkulloni.
2. **Mësoni se si duhet të firmosin njerëzit petitionin në mënyrë që të konsiderohet i vlefshëm.** Nëse ju po përpiqeni që të vendosni emrin e një kandidati në fletën e votimit, dhe ligji kërkon që ju të vendosni adresën për çdo emër, kërkojini këtë gjë njerëzve që firmosin petitionin tuaj.

3. Bëni një kërkim për temat që ju keni përzgjedhur në mënyrë që të keni një kuptueshmëri nga disa këndvështrime.

Kërkimet që mund të bëni për çështjen tuaj, janë një mënyrë e mirë për të zbuluar nëse dikush tjetër ka filluar një petition për të njëjtën çështje.

4. Kuptoni kush është ambjenti ideal që ju të shpërndani/qarkulloni petitionin.

Pavarësisht nga zgjedhja juaj, përsëri ju do t'ju duhet të shkruani një petition ashtu siç duhet. Peticionet në letër mund të jenë më të përshtatshme për peticione në nivel lokal, por peticionet online mund të arrijnë një audiencë shumë më të madhe të grupeve të njerëzve në një kohë shumë të shkurtër. Gjithashtu, Kauzat e Facebook mund të jenë një mënyrë shumë e mirë për të marrë mbështetje online për një çështje të caktuar. Detajet janë shumë të rëndësishme si për peticionet online ashtu edhe për ato në letër.

Shkrimi i petitionit

Zhvilloni një deklaratë shumë specifike që identifikon atë që kërkon që të mbështesin njerëzit. Duhet të jetë e saktë, konçize dhe informative.

Shembuj të një deklaratë të keq strukturuar dhe të mirë strukturuar:

E keq strukturuar: Ne mbështesim idenë për fonde për një park! Kjo fjali është shumë e përgjithshme. Cfarë lloj parku? Sa fonde? Ku është parku?

E mirë strukturuar: Ne kërkojmë që Këshilli Bashkiak Dibër të alokojë fonde për një park lojrash në Brezhdan. Në këtë fjali, detajet e sakta janë qartësisht të përshkruara.

- a.** Bëni një peticion të shkurtër. Njerëzit do të kenë më pak gjasa të t'ju mbështesin nëse duhet të kalojnë shumë kohë duke lexuar atë që duhet të thuash. Pa marrë parasysh se sa e gjatë është kërkesa juaj, duhet të vendosni qëllimin tuaj në fillim të paragrafit të parë. Pastaj vazhdojeni atë me arsyen (et) tuaja për këtë peticion. Ky do të jetë paragrafi që shumica e njerëzve do të lexojnë.

Shembuj të paragrafit të parë të një peticioni: *Ne kërkojmë që Këshilli i Bashkisë Dibër të alokojë fonde për një kënd lojrash në Brezhdan. Kjo zonë nuk ka asnjë kënd lojrash. Fëmijët tanë kanë nevojë të kenë një vend ku të shijojnë natyrën dhe të luajnë.*

- b.** Shtoni paragrafë të tjerë shoqërues për të mbështetur të parin. Këto paragrafe duhet të mbajnë informacione dhe shembuj specifikë që tregojnë rëndësinë e asaj për të cilën ju po luftoni. Shkruani aq paragrafe sa keni dëshirë, por keni parasysh që shumica e njerëzve me të cilët ju do të kontaktoni në rrugë nuk do t'i lexojnë të gjitha këto paragrafe.
- c.** Lexoni me kujdes përmbledhjen që keni hartuar. Sigurohuni që: (1) përshkruan situatën, (2) sugjeron atë që nevojitet (3) shpjegon arsyen përse është e nevojshme. A është e qartë? Nëse ju nuk do të dinit se për çfarë bëhej fjalë, a do t'a kuptonit situatën duke lexuar peticionin tuaj?
- d.** Korrigjoni peticionin tuaj për gabime gramatike. Nëse peticioni juaj është me gabime, me shumë mundësi njerëzit nuk do t'a marrin seriozisht. Lexojeni me zë të lartë për të kuptuar nëse ka kuptim ajo çfarë keni shkruar.
- e.** Merrni dikë tjetër që të lexojë peticionin tuaj, mundësisht një mik apo të afërm i cili është i përfunduar rreth situatës.

A e kupton personi qëllimin tuaj? A mund të tregojë përse po e bëni këtë peticion; çfarë kërkonti dhe pse po e kërkonti?

Hartimi i formularit ku do të firmoset/nënshkruhet

Hartoni një form tablele ku të listoni firmat e personave që mbështesin peticionin. Vendosni titullin e peticionit në krye të faqes. Titulli i peticionit duhet të jetë konciz por përshkrues.

Shembull i një titulli peticioni: *Peticion për Këndin e Lojrave në Brezhdan.*

Përgatisni një model tablele ku të vendosni të dhënat e mëposhtme: Do të dukej më profesionale dhe do të ishte më e thjeshtë për t'a ndryshuar nëse do të ishte e nevojshme. Ndaje faqen në pesë kolona dhe në krye të cdo kolone shkruani: Emri, Adresa, Adresa E-mail, Telefoni dhe Firma. (Në disa raste do t'ju duhet të shtoni edhe një kolonë tjetër për të vendosur numrin e ID për cdo individ). Kolonën e Adreses, bëjeni më të madhe se kolonat e tjera. Vendos 10 deri në 20 rrjeshta për faqe.

Printo ose fotokopjo disa kopje të orgjinalit.

Bëni faqe të mjaftueshme për numrin e firmave që ju nevojiten. Numëroni faqet në mënyrë që të dini se sa keni dhe sa firma keni marrë. Gjithashtu ju mund të dëshironi që nënshkruesit e peticionit të shohin faqet e para të peticionit dhe mund t'i drejtoni disa pyetje atyre rreth asaj është shkruar dhe se çfarë mendojnë? Faqet në fillim të peticionit rrisin llogaridhënien e përgjithshme.

Promovimi i peticionit tuaj

Flisni vetë me njerëzit. Shkoni aty ku mund të flisni me një grup të madh njerëzish të cilët janë të interesuar për këtë çështje ose janë të hapur të dinë më shumë rreth saj. Ndoshta publiku ka nevojë të dijë më shumë rreth peticionit tuaj, nëse është kështu, shkruani një fjalim. Shkoni në një vënd publik ku ka njerëz të cilët ju doni t’i informoni dhe mund t’ju dëgjojnë. Sigurohuni që të keni leje për t’a bërë këtë gjë. Nëse peticioni juaj ka lidhje me shkollën, flisni me njerëzit që janë në shkollë apo afër saj. Shpërndani fjalën për peticionin nëpërmjet zyres tuaj. Ngjisni postera në tabelat ku vendosen informacione për komunitetin/publikun.

Përdorni fuqine e E-mail. Krijoni një version online të peticionit tuaj dhe dërgojeni te familjarët, miqtë e të njohurit tuaj. Përpiquni që mos ti “mbysni” ata me e-maile, edhe pse mund të dërgoni një email çdo ditë gjatë një muaji, nuk do të keni rezultatin që dëshironi. Ajo që mund të bëni është që pas dërgimit të peticionit të dërgoni, dy ose tre e-maile rikujtese gjatë periudhës së peticionit.

Krijoni prezencë online për peticionin tuaj. Krijoni një blog apo forum online ku mund të diskutoni peticionin tuaj dhe ti përgjigjeni pyetjeve të personave që mund t’a firmosin atë. Platforma mediatike online si Facebook dhe Tëitter janë shumë të mira për të shpërndarë fjalën dhe mund të ndihmojnë që një lëvizje të marë përmasa të mëdha duke marë edhe vëmendje në nivel kombëtar. Ëëbsite-t e mira janë më të tjeshtë! Ata gjithashtu njoftojnë njerëzit për të cilët ju krijuat peticionin rreth njerëzve që e kanë nënshkruar atë.

Kontaktoni median. Kontaktoni me median lokale për çështjen tuaj; përpiquni të shkoni në një emision radioje apo të publikoni një artikull në një gazetë. Ndërkohë që peticioni juaj mer vull, të njëjtën gjë do të bëjë edhe përhapja.

Jini i sjellshëm. Asnjë nuk ka dëshirë të takojë një person të inatosur që bën peticion ndërkohë që po shkon në punë. Edhe pse dikush beson në kauzën tuaj, ata ndoshta nuk kanë kohën apo fondet për t’ju mbështetur ju në atë moment. Mos e mer personale! Është gjithmonë mirë që të jeni të sjellshëm – ata mund t’ju kontaktojnë apo t’ju ndihmojnë në financimin e kauzës tuaj kur të kenë kohë dhe burime.

Ndarja e Informacionit:

Shpërndani fletushka me informacion. Hartoni një fletushkë e cila përmban informacion thelbësor rreth çështjes tuaj, emrin e organizatës/grupit tuaj, orën dhe datën ku mund të takohen me ju dhe vendosni cafrëdolloy informacioni tjetër që doni t’a ndani me njerëzit.

Shpërndani fletushkat në shkollë, lagje (por fillimisht kontrolloni nëse ka ndonjë rregull i cili kufizon shpërndarjen e tyre apo/dhe ku lejohet ofrimi i informacionit për publikun); tabelat e informimit për komunitetin, brenda lokaleve, dyqaneve, qendrave shëndetësore, ndërtesës së pushtetit lokal.

- ❖ Përveç fletushkave, ju mund të shpërndani kartolina, letra me ngjitëse apo material të tjera që ndihmojnë në përhapjen e fjalës rreth asaj që po bëni.
- ❖ Ndërkohë që ju shpërndani materialet tuaja, jini i dëshirës për t’ju përgjigjur pyetjeve të njerëzve dhe bëni diskutime rreth çështjes tuaj.

● **Protestat/demonstratat**

Edhe pse shpesh për demonstratat mendojmë se janë negative dhe kundër "diçkaje", ato gjithashtu mund të jenë pozitive, duke mbështetur politikanë të veçantë dhe idetë e tyre, iniciativa specifike ose programe ekzistuese. Ata zakonisht kanë për qëllim të ndikojnë në mënyrën se si gjërat janë bërë, ose mënyrën se si njerëzit mendojnë. Nëse ata kanë për qëllim politikanët, autoritetet e pushtetit vendor, korporatat, ose publikun e gjerë, ata mund të marrin shumë forma. Nga marshime të mëdha, të mbuluara nga mediat, deri në tubime të vogla apo pjesë teatrale në bulevardin e qytetit.

Qëllimet e përbashkëta për demonstrata përfshijnë...

- ❖ **Advokacia:** Nxit politik-bërësit apo publikun të shikojnë apo mbështesin në mënyrë të favorshme një ide ose politikë ose shërbim të veçantë ose t'i kushtojnë vëmendje nevojave të një grupi të caktuar njerëzish, p.sh. nevojat për personat me aftësi të kufizuara ose përmirësime në shërbimet arsimore.
- ❖ **Mbështetja:** Shpreh mbështetjen ose solidaritetin me një person ose grup, me një ide ose politikë, apo me një çështje të veçantë. Për shembull, një grup komuniteti mund të mbajë një demonstratë në komunitet për të mbështetur ngritjen e propozuar të shërbimeve më të mira për fëmijët me aftësi të kufizuara në komunitet.
- ❖ **Protesta:** Flet kundër disa padrejtësive, korrupsionit, figures/ave publike të korruptuara ose kërkesës për rritjen e pagesës së ndihmës ekonomike.

- ❖ **Marrëdhëniet me Publikun:** Promovojnë një ngjarje, çështje, organizatë ose grup komuniteti që ka nevoja specifike.
- ❖ **Veprimi:** Veprimet realizojnë një qëllim specifik, parandalojnë ose ndryshojnë një ngjarje të caktuar, ose ndikojnë në rrjedhën e ngjarjeve. Për shembull, punonjës të arsimit që kërkojnë shërbime më të mira arsimore për fëmijët e vegjël ose aktivistët e paqes që lidhen me zinxhir në portat e një baze ushtarake.
- ❖ **Një kombinim** i të gjithave sa më sipër.

Në të vërtetë, shumica e demonstratave i shërbejnë më shumë se një qëllimi. Pavarësisht nga synimet e tjera që ata kanë, shumica e organizatorëve kërkojnë mbulim mediatik për demonstratën me qëllim që të tërheqin vëmendjen. Shumica e demonstratave ose avokojnë dhe mbështesin, ose protestojnë kundër diçkaje. Dallimi është në theks, i cili mund të ketë një efekt të madh në formën dhe kohën e demonstratës.

- ❖ **Marshimet dhe paradat.** Këto janë rastet klasike: numri i njerëzve që marshojnë në një rrugë nga një vend i rëndësishëm në tjetrin për të theksuar angazhimin e tyre për një çështje të veçantë. Në nivel lokal, një demonstrim i tillë mund të përfshijë një marshim nga një vend i caktuar deri në qëndër të qytetit apo vëndit ku banon, ku shqetësimet e marshuesve shprehen në fjalime ose në mënyra të tjera. Marshimet dhe paradat zakonisht shoqërohen me avokim, mbështetje, ose protestë, dhe shpesh shërbejnë për ndërtimin e marrëdhënieve me publikun.

- ❖ **Tubimet.** Demonstruesit mblidhen vetë në një vend të caktuar, ku dëgjojnë fjalime ose marrin pjesë në aktivitete të tjera ku shprehin shqetësimet e tyre (muzika dhe / ose komentet nga njerëz të famshëm janë të zakonshme). Tubimet, ashtu si marshimet, përveç ofrimit të mundësive për shprehje të fuqishme në media, zakonisht shoqërohen me advokimin, mbështetje, protestë dhe kundër-demonstrimin.
- ❖ **Piketimi.** Rastet më klasike: një grup njerëzish që mbajnë shenja të cilat shprehin shqetësimet e tyre dhe shpesh, identifikojnë aleatët dhe antagonistët/kundërshtarët e tyre, qëndrojnë ose ecin përpara një ndërtese apo objekti që është objektivi i demonstratës së tyre. Një grup konsumatorësh mund të piketojnë një dyqan në një përpjekje për të bindur klientët potencialë se do të ishte më mirë për ata që të blejnë diku tjetër. Piketimi gjithmonë përfshin veprime të drejtpërdrejta, dhe nganjëherë mbart me vete mundësitë e dhunës dhe arrestimit.
- ❖ **Qëndrimi ulur i një grupi.** Në një rast të tillë, demonstruesit bëjnë vetëm këtë: zënë një hapësirë në një zyrë qeveritare, një rrugë, një ndërtesë të caktuar, apo në një park dhe ulen. Ndonjëherë, kjo gjë shoqërohet me fjalime ose aktivitete të tjera; Ndonjëherë është e heshtur.

Kur demonstruesit veprojnë qwillimisht në një mënyrë që ata e dinë se është e paligjshme me qëllim për t'a bërë çështjen e tyre jashtëzakonisht të fuqishme ose të tregojnë imoralitetin ose gabimin për një ligj ligj, ata janë të angazhuar në mosbindje civile. Kjo strategji është përdorur nga Gandi dhe Martin Luter King dhe pasuesit e tyre, për shembull, për të treguar se ata nuk do të toleronin ligjet ose kushtet që ishin qartësisht të gabuara moralisht.

❖ **Lobimi në institucionet qeveritare**

Lobimi zakonisht fokusohet që të ndikojë direkt tek vendimmarrësit. Një nga themelet më të rëndësishme të lobimit janë marrëdhëniet e mira me vendimmarrësit. Ofrimi i informacionit të përmbledhur në mënyrë periodike për ta dhe stafin e tyre është një mënyrë për të forcuar marrëdhëniet. Në këto takime zakonisht paraqiten ekspertë që flasin për informacionin më të ri rreth çështjes. Kur lobohet është e rëndësishme që:

- Të ketë një program dhe prioritete të qarta. Jini të saktë dhe të shkurtër në përcaktimin e çështjeve dhe pritshmërive
- Jini të përgatitur për biseda me pika të qarta për argumenta. Bëni të qartë se jeni të gatshëm të ndihmoni me informacion dhe mbështetje, mos shmangni tema të diskutueshme, por qëndroni të qetë gjatë diskutimeve. Debati është i mirë, por shmangni agresivitetin.
- Kur takimi të përfundojë, sigurohuni që të lini broshura, fletë informuese ose informacione të tjera të printuara për të mbështetur më shumë çështjen tuaj.
- Pas largimit nga takimi, mbani shënime dhe bëni një vlerësim të vizitës bashkë me kolegët. Gjithmonë dërgoni një përmbledhje të takimit ku përfshihen detaje të sakta dhe me aq sa mundeni, legjitimoheni.

Shkrimi i një letre personale:

Një letër e shkruar mirë është një nga mënyrat më me ndikim për të komunikuar me vendimmarrësit. Kur shkruani letër, mbani në mend udhëzimet e mëposhtme:

- Sigurohuni që emri dhe titulli i vendimmarrësit që po i shkruani, janë të sakta dhe të shkruara siç duhet.
- Nëse është e nevojshme, kontrolloni nëse duhet të përdorni një formë të përshtatshme për t'ju adresuar, si psh: Shkëlqesia e Tij, I/E nderuar etj.
Jini të sjellshëm dhe mbuloni **vetëm një çështje** në letër.
- Mos përdorni zhargon, akronime të panjohura ose terminologji të OJQ-ve. Përdorni fjalët tuaja.
- Mos shkruani një letër të gjatë, por jo shumë të shkurtër. Gjithnjë këshillohet të shkruash një letër që nuk është më shumë se një faqe. Me këtë letër ju doni të tregoni se e kuptoni çështjen dhe duhet të shprehni shqetësimin tuaj.
- Nëse përfshini një pyetje, marrësi do të jetë më i prirur për t'ju përgjigjur në letrës tuaj. Sigurohuni që të keni një pyetje. Megjithatë, nëse çështja juaj sjell më shumë pyetje, është e pranueshme të përfshijë deri në tri pyetje. Jini shumë të kujdesshëm në lidhje me tonin dhe formën e pyetjeve.
- Në letër ju duhet të përfshini veprimin që do të dëshironit që vendimmarrësi të marrë në lidhje me çështjen.
- Nëse shkruani në emër të organizatës suaj sigurohuni që të thoni atë që bëni.

- Nënshkruani letrën tuaj mbi emrin dhe adresën tuaj. Zarfet zakonisht hidhen, prandaj sigurohuni që të vendosni adresën tuaj edhe brenda.

Deklaratat për Shtyp

Për të qenë efektiv në përcimin e mesazheve tuaja duhet të njihni auditorin tuaj, njerëzit që po përpiqeni të ndikoni.

Duhet të mbani gjithnjë parasysh se një mesazh i qartë përmban një gjuhë të kuptueshme dhe sugjeron veprime që auditori i synuar mund të bëjë.

1. Kjo do të thotë që për të pasur një mesazh të mirë, ndonjëherë duhet të bëni kërkime për audiencën tuaj të synuar. Ju duhet të mësoni se cila është mënyra më e mirë për të ndikuar tek njerëzit që po synoni me mesazhin. Gjithashtu, mesazhi duhet të marrë parasysh interesat, idetë dhe njohuritë e tyre.
2. Mbajeni të thjeshtë. Mesazhet duhet të jenë të shkurtra, vetëm pak fjali. Duke dhënë shumë mesazhe, rrezikoni që audienca juaj t'i harrojë ato. Sa herë që të mundeni, limitohuni vetëm në një mesazh i cili do të fokusohet në argumentet tuaja më të mira mbështetëse.

Shembull i një Mesazhi të Keq:

"Duke qënë se përfitimet e arsimit parashkollor janë të padiskutueshme, të gjithë fëmijët duhet t'a frekuentojnë atë"

Shembull i një Mesazhi të Mirë:

"Hulumtimet tregojnë se përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor që nga mosha e hershme ka një ndikim pozitiv në aftësitë sociale të fëmijëve dhe arritjet akademike gjatë gjithë jetës së tyre, gjë që pasqyron pozitivisht ekonominë e vendit në planin afatgjatë. Prandaj, ju lutem mbështesni Manifeston e "Fëmijërisë së Hershme" të Precede Albania. Ndihamoni rritjen e numrit të fëmijëve që kanë një vend në kopshte dhe mësojnë përmes edukimit cilësor parashkollor. "

● Fushatat televizive:

Në mënyrë që mesazhi të dëgjohet nga audienca e duhur, duhet të identifikojmë mundësitë se kur duhet të shpërndajmë/përhapim këto mesazhe, të zgjedhim formatin më të mirë dhe të punojmë në mënyrë efektive me median dhe partnerët. Një analizë e mirë e procesit të vendimmarrjes, mund t'ju ndihmojë të identifikoni mundësitë dhe pikat hyrëse për të filluar ndikimin tek vendimmarrësit. Këto mundësi mund të përdoren për të forcuar advokimin, për të krijuar aleanca, për të rritur ndërgjegjësimin si dhe për të përçuar mesazhin e advokimit.

Për të përfituar sa më shumë nga mundësitë, advokuesit kanë nevojë për ide të qarta se si mund të përdorin mundësitë e disponueshme dhe çfarë do të arrihet. Është shumë e rëndësishme që të identifikohen dhe ndiqen mundësitë që kanë potencialin më të mirë në promovimin e çështjes.

Procesi i shpërndarjes së mesazhit ka të bëjë me zgjedhjen e lajmëtarit dhe si do të transmetohet mesazhi; formati më i dobishëm.

A duhet të përdorim:

- ❖ Letrat e printuara për vendimmarrësit, artikuj reviztash, gazeta, postera, fletëpalosje, fletushka, raporte apo studime?

- ❖ Media elektronike - e-mail, televizion, radio, median sociale, YouTube apo aplikacionet në telefon?

Më poshtë është një listë me pyetje që mund t'ju ndihmojnë për të zgjedhur formatin më të përshtatshëm:

- ❖ Kush janë burimet kryesore të audiencës për të marrë informacione?
- ❖ Kë apo çfarë dëgjojnë?
- ❖ Cfarë lexojnë?
- ❖ Cfarë shikojnë?
- ❖ Cfarë ju tërheq vëmëndjen?
- ❖ Kush janë karakteristikat e audiencës: mosha, gjinia, status i punësimit, çfarë prioritesh kanë?
- ❖ Ku dhe kur?
- ❖ A ka ditë kombëtare apo ndërkomëbtare që festohen/kujtohen të cilat mund të përdoren për të promovuar çështjen tuaj për të fituar më shumë publicitet dhe fokus?

Plani Strategjik 2016 – 2019

Duke patur parasysh qëllimet e planit strategjik, Grupi i Aktivistëve ka vendosur që për të arritur qëllimet e tyre të zhvillojnë Planin Advokues si më poshtë.

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---|--|--|---|---|
| <p>Planifikimi, zhvillimi dhe hapja e një qendre shumë-disiplinare ditore plotësisht funksionale për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara në Bashkinë Dibër.</p> | <p>1. Takime me anëtarët e Këshillit Bashkiak Dibër për të advokuar për ofrimin e qendrës ditore shumë-disiplinare.</p> <p>2. Firmosja e Marrëveshjes me Bashkinë Dibër për përdorimin dhe paisjen e një ndërtese lehtësisht të aksesueshme për Qendrën Ditore.</p> <p>3. Zhvillimi i planeve të brendshme dhe të jashtme për ndërtesën e dhuruar nga Bashkia Dibër.</p> | <p>1. Grupi Aktivistëve</p> <p>2. Kryebashkiaku dhe kryetari i Grupit të Aktivistëve.</p> <p>3. Departamenti i Planifikimit në Bashkinë Dibër & Grupi Aktivistëve.</p> | <p>1. Marrëveshja për hapjen, stafin dhe për alokimin e një buxheti vjetor për Qendrën Ditore.</p> <p>2. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit.</p> <p>3. Plan i detajuar për paisjen dhe përshtatjen e ndërtesës për Qendër Ditore.</p> | <p>1. Nëntor 2016</p> <p>2. Dhjetor 2016</p> <p>3. Dhjetor 2016</p> |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|----------------|--|----------------------------|---|------------------------|
| | 4. Kontraktimi i një Kompanie ndërtimi për të pajisur qendrën dhe për të siguruar akses për çdo person me aftësi të kufizuara. | 4. Grupi Aktivistëve. | 4. Tender i hapur; 4.1 Përzgjedhja e kompanisë; 4.2 Firmosja e kontratës. | 4. Shkurt 2017 |
| | 5. Zhvillimi i materialeve informuese për të rriturit dhe familjet në Bashkinë Dibër. | 5. Grupi Aktivistëve | 5 Materiale informuese për t'u shpërndarë në të gjithë bashkinë. | 5. Shkurt 2017 |
| | 6. Intervista me median lokale për të promovuar shërbimet që do të ofrojë Qendra Ditore. | 6. Grupi Aktivistëve | 6 Promovimi i qendrës ditore. | 6. Mars – Prill 2017 |
| | 7. Fushatë për rritje fondesh për paisje dhe materiale për qendrën ditore; | 7. Grupi Aktivistëve | 7 Sesion me pyetje dhe përgjigje për komunitetin. | 7. Prill 2017 |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---------|--|--|---|---|
| | <p>8. Dita e hapjes së qendrës për anëtarët e komunitetit për t'u takuar me stafin dhe për të parë qendrën.</p> <p>9. Ditë e hapur për anëtarët e komunitetit për të parë qendrën dhe për të takuar stafin</p> | <p>8. Grupi Aktivistëve</p> <p>9. Grupi Aktivistëve & Stafi i Qendrës Ditore</p> | <p>8 Materiale për fushatë rritje fondesh; fletushka, postera, kuti në dyqane, shkolla etj.</p> <p>9 Prezantimi i shërbimeve, Fotografi të intervistave të bëra në media, te fushatës për rritje fondesh.</p> | <p>8. Qershor 2017</p> <p>9. Shtator 2017</p> |
| | | | | |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---|--|---|--|--|
| <p>Deri në Shtator 2017 të përmirësohet akses, ambjenti dhe ofrimi i shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla. Këtu përfshihet ofrimi i rregullt i mësuesit ndihmës për fëmijët; akses</p> | <p>1. Diskutime dhe takime me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë ose jo shkollën.</p> <p>2. Analizimi i të dhënave të mbledhura në Bashkinë Dibër dhe përgatitja e një broshure të shkurtër me rekomandime.</p> | <p>1. Grupi Aktivistëve</p> <p>2. Grupi Aktivistëve dhe vullnetarët</p> | <p>1. Informacion i detajuar rreth numrit të fëmijëve që frekuentojnë shkollën; ofrimi i mësuesve ndihmës; llojet e pengesave që parandalojnë përfshirjen e çdo fëmije në shkollë dhe nevoja për transport.</p> <p>2. Broshurë e shkurtër për Drejtorin e Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe zyrën e Arsimit në Bashkinë Dibër</p> | <p>1. Shkurt 2017</p> <p>2. Prill 2017</p> |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---|--|---|--|--------------------------------------|
| <p>në dhe brënda kopshteve dhe shkollave për të gjithë fëmijët dhe të rriturit dhe transport falas për fëmijët me aftësi të kufizuara të lëvizshmërisë nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.</p> | <p>3. Diskutime dhe takime me Drejtorin e Drejtorisë Arsimore Rajonale, zyrën e Arsimit në Bashkinë Dibër, Kryebashkiakun & anëtarët e Këshillit Bashkiak.</p> | <p>3. Grupi Aktivistëve dhe perindërit e interesuar</p> | <p>3. Informimi i autoriteteve të pushtetit lokal rreth nevojës për përmirësime në aksesin në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara.</p> <p>3.1 Identifikimi i një mënyre bashkëpunuese për të lobuar me bashkinë dhe këshillin bashkiak që të bëjë përmirësimet e nevojshme.</p> | <p>3. Prill, Maj & June 2017</p> |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---------|---|---|--|--|
| | <p>4. Takime informuese me publikun për të marrë më shumë mbështetje për të përmirësuar kopshtet dhe shkollat.</p> <p>5. Diskutime dhe takime me Drejtorët e Drejtorise Arsimore Rajonale dhe Departamentin e Arsimit në Bashkinë Dibër; prezantimi i listës me firmat e mbledhura dhe kryerja e një marrëveshjeje për përmirësimet e nevojshme</p> | <p>4. Grupi Aktivistëve dhe Prindërit</p> <p>5. Grupi Aktivistëve dhe prindërit</p> | <p>4. Qytetarë të informuar të gatshëm për të mbështetur fushatën</p> <p>4.1 Firmosja e peticionit për të përmirësuar aksesin në shkolla si dhe vendosja e mësuesve ndihmës.</p> <p>5. Marrëveshjeje për numrin e mësuesve ndihmës që do të punësohen në çdo shkollë nga Shtatori 2017</p> <p>5.1 Marrëveshjeje për numrin e shkollave që do të pajisen me</p> | <p>4. Korrik 2017</p> <p>5. Shtator 2017</p> |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---------|-------------------------------|---------------------|--|-----------------|
| | për vitin akademik 2017-2018. | | <p>pasije të nevojshme për të përmirësuar nivelin e aksesit gjatë vitit akademik 2017-2018.</p> <p>5.2 Marrëveshje për transportin falas për fëmijët me aftësi të kufizuara në zonat të cilat janë të vështira për të udhëtuar apo ecur.</p> | |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---|--|----------------------|---|-----------------|
| Përmirësimi i pagesës së Ndhmës Ekonomike mujore për individët dhe familjet në Bashkinë Dibër. | 1. Mbledhja e të dhënave specifike mbi shpenzimet e ushqimit, veshjeve, shërbimeve dhe artikujve bazë për të rriturit dhe fëmijët në Bashkinë Dibër për të zhvilluar kostot mesatare të jetesës. | 1. Grupi Aktivistëve | 1. Listë e detajuar e kostove totale të artikujve bazë | 1. Mars 2017 |
| | 2. Takime me Drejtorin e e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve Shoqërore. | 2. Grupi Aktivistëve | 2. Diskutime dhe marrëveshje me bashkinë për të rishikuar nivelin e Ndhmës Ekonomike për individët dhe familjet me fëmijë | 2. Prill 2017 |
| | 3. Monitorimi i takimeve të | 3. Grupi Aktivistëve | 3. Rritja e pagesës së | 3. Korrik 2017 |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---------|--|--|--|---|
| | <p>Këshillit të Ministarve në diskutimet e buxhetit në lidhje me rrijen e pagesës së Ndhmës Ekonomike.</p> <p>4. Intervista në radio & televizion për të debatuar rreth kërkesës për rritjen e nivelit të pagesës së Ndhmës Ekonomike për individët dhe familjet.</p> <p>5. Prezantimi i listës me firmat e banorëve të Bashkisë Dibër që kërkojnë rritje të pagesës së Ndhmës Ekonomike tek Kryatri i Bashkisë dhe Këshillit të Ministrave.</p> | <p>4. Grupi Aktivistëve</p> <p>5. Grupi Aktivistëve dhe mbështetësit</p> | <p>Ndhmës Ekonomike</p> <p>4. Informimi i anëtarëve të komunitetit</p> <p>4.1 Mbledhja e sa më shumë mbështetësve për fushatën</p> <p>5. Marrëveshje ose vendim i Këshillit të Ministrave për të rritur nivelin e pagesës mujore të Ndhmës Ekonomike</p> | <p>4. Qershor - Shtator 2017</p> <p>5. Tetor 2017</p> |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|--|---|--|--|----------------------|
| | 6. Prezantimi i pagesave të reja të Ndihmës Ekonomike. | 6. Grupi Aktivistëve dhe mbështetësit. | për individë/familje. 6. Prezantimi i suksesit të fushatës dhe promovimi i punës së Grupit të Aktivistëve . | 6. Tetor/Nëntor 2017 |
| Rritja e numrit dhe aksesit të këndëve të lojrave për | 1. Mbledhja e informacionit rreth këndëve të lojrave të përshtatshme për fëmijët e vegjël, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuara në Bashkinë | 1. Grupi Aktivistëve | 1. Lista e këndëve të lojrave që janë aktualisht dhe në çfarë gjëndje janë. | 1. Shtator 2017 |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---------------------------------------|--|----------------------|---|-----------------|
| fëmijët e vegjël në komunitete | Dibër. | | | |
| | 2. Studim në familje, Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Departamentin e Kulturës në Bashkinë Dibër rreth nevojës për kënde lojrash. | 2. Grupi Aktivistëve | 2. Informacion rreth nivelit të nevojës dhe komuniteteve me nivelin më të lartë të numrit të fëmijëve të vegjël për 5 vitet e ardhshme. | 2. Nëntor 2017 |
| | 3. Zhvillimi i kërkesës për Kryebashkiakun, Këshillin Bashkiak dhe median. | 3. Grupi Aktivistëve | 3. Artikulimi dhe shkrimi i detajeve rreth nevojës për kënde lojrash, sa, ku, numri fëmijëve që mund t'a përdorin, dhe kostoja me përfaqësim. | 3. Dhjetor 2017 |
| | 4. Prezantimi formal në | 4. Grupi Aktivistëve | 4. Prezantimi. | 4. Dhjetor 2017 |

| Qëllimi | Veprimet | Personat Përgjegjës | Rezultati (et) për tu Arritur | Koha e Arritjes |
|---------|---|---|---|---|
| | <p>mbledhjen e Këshillit Bashkiak i kërkesës për ndërtimin e këndeve të lojrave, pajisen dhe mirëmbajtjen e tyre përmes buxhetit vjetor të Bashkisë duke filluar nga Janari 2018.</p> <p>5. Monitorimi i progresit të ndërtimeve dhe aksesueshmërisë së këndeve të lojrave.</p> <p>6. Njoftimi i fëmijëve dhe familjeve dhe hapja e këndeve të lojrave.</p> | <p>dhe mbështetësit</p> <p>5. Grupi Aktivistëve & media</p> <p>6. Grupi Aktivistëve, Kryebashkiaku i Dibrës & media</p> | <p>4.1 Komentet dhe minutat e takimit të Këshillit Bashkiak dhe përfundimet e kërkesës</p> <p>5. Kënde lojrash të kompletuara, të sigurt dhe të aksesueshme për fëmijët e vegjël</p> <p>6. Hapja e këndeve të lojrave ku fëmijët luajnë dhe argëtohen.</p> <p>6.1 Publikimi i ndikimit të punës së Grupit të aktivistëve në Komunitet</p> | <p>5. Maj 2018</p> <p>6. Maj/Qershor 2018</p> |



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC